

**Ajo quhet N.A. përfituese e shërbimit ligjor falas ofruar nga QNL.
Bashkë me N.A., ne kemi një histori për të treguar.**

N.A., përfituese e shërbimit ligjor falas ofruar nga QNL: “Shërbimi i ofruar nga avokatet e QNL ka qenë shumë jetik në lidhje me problemet e mia ligjore”.

N.A, është paraqitur pranë Qendrës pasi kishte zgjidhur martesën. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur edhe për pasojat e zgjidhjes së martesës duke ia dhënë, nënës, të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për fëmijët e mitur A.D dhe N.D si dhe duke caktuar detyrimin ushqimor të babait kundrejt dy fëmijëve. N.A. është kujdesur e vetme për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve prej muajit shtator 2012, sepse ish-bashkëshorti nuk ka paguar detyrimin ushqimor për fëmijët dhe nuk ka takuar fëmijët. Ish bashkëshorti i NA jeton jashtë vendit dhe ky fakt i ka sjell vështirësi asaj dhe fëmijëve, në lidhje me zbatimin e vendimit të gjykatës dhe lëvizjen e lirë të fëmijëve jashtë vendit për vizita tek të afërmit e nënës.

Avokatet e QNL vunë në lëvizje gjykatën në dy procese gjyqësore civile. Avokate Iris Aliaj, pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare tregon se:

Së pari, u kërkua njohja dhe zbatimi i vendimit të formës së prerë nr.....të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për detyrimin ushqimor ndaj fëmijeve”, i lënë në fuqi me vendimin nr.të Gjykatës së Apelit Tiranë, në Republikën e Greqisë. Me këtë kërkesë zbatuam drejtpërdrejtë Konventën ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale", ratifikuar me Ligjin nr.7760, datë 14.10.1993 dhe u referuam në Ligjin nr. 9554, datë 8.6.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pranoi kërkesën tonë për njohjen dhe zbatimin në shtetin e Greqisë të vendimit të formës së prerë.

Vendimi i gjykatës, së bashku me dokumente të tjera i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, e cila ka filluar procedurat për ekzekutimin e tij nëpërmjet komunikimit me Ministrinë e Drejtësisë së Shtetit Grek.

Kjo praktikë e re në zbatim të Konventës së Hagës për zbatimin e vendimeve gjyqësore që lidhen me detyrimet ushqimore për fëmijët e mitur është vlerësuar dhe mirëpritur nga Ministria e Drejtësisë në shtetin Grek, si një praktikë e re edhe për ta në përmbushje të detyrimeve që u burojnë nga kjo konventë.

Kjo praktikë e re është shumë e rëndësishme për ekzekutimin e vendimeve të detyrimeve ushqimore në shtete të tjera, ku prindi debitor ka vendqëndrimin apo vendbanimin, por kërkon përshpejtimin e procedurave nga Ministria e Drejtësisë së shtetit tonë me qëllim, garantimin de fakto të të drejtave të fëmijëve dhe nënës N.A.

Së dyti, Për më shumë se 5 vjet N.A. nuk udhëtonte me fëmijët e saj jashtë vendit, për pushime, për të takuar të afërmit, si dhe për vazhduar vaksinimin e fëmijëve, të cilët kanë lindur në shtetin Grek. Djali i mitur N.D, i cili është pjese e një skuadre futbollit të rinjsh nuk kishte mundur të udhëtonte me skuadrën e tij për ndeshje futbollit në shtete të ndryshme, për shkak të mos shprehjes së vullnetit të babait të fëmijëve, ish bashkëshortit të N.A. para noterit. Ky fakt ka sjellë pasoja në mirëqenien emocionale të fëmijës. Në këto kushte, në të njëjtën kohë iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kërkua autorizim nga gjykata për të kryer veprime juridike në interesin e fëmijëve në lidhje me edukimin, mirërritjen, shkollimin, kujdesin shëndetësor të tyre si dhe lejimin për të lëvizur me fëmijët e mitur A.D dhe N.D jashtë vendit, pa përcaktuar afat ligjor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi të pranojë kërkesën. Nëpërmjet kësaj praktike, QNL ka ndihmuar shumë gra të cilat pasi zgjidhin martesën e kanë të pamundur të lëvizin lirisht me fëmijët e tyre të mitur, për kujdes shëndetësor, takimin e të afërmeve, pushime, arsimin, argëtim, etj.

N.A. shprehet se: “Mbështetja e marrë nga avokatet e QNL ka qenë shumë efikase dhe pa shpenzime monetare, gjë që është shumë shumë e rëndësishme, pasi jam në kushtet që përballoj e vetme çdo shpenzim për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Paratë që do të me duheshin për të marrë një avokat për të ndjekur këto procese, i kam investuar tek fëmijët e mi.

Uroj që nga puna e avokateve të kësaj qendre të përfitojnë sa më shumë fëmijë dhe nëna, të cilat mund të jenë në kushte të njëjta apo edhe më të vështira”.